Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0748

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Isa Hasani - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "AgriBau" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Furnizim me Piruner"me nr. të prokurimit:"214-23-8209-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosoves, me datën, 05.01.2023 mori këtë:

Vendim

1.Aprovohet**,** si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "AgriBau" SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit, nr.748/23, kundër, "Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues" datës,15.09.2023, për anulimin e aktivitetit prokurimit me titull: "Furnizim me Piruner" me nr. të prokurimit: "214-23-8209-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosovës.

2.Anulohet"Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues " i datës,15.09.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "214-23-8209-1-2-1" dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

3.Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës "AgriBau" SH.P.K., dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- *Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 09.08.2023, Policia e Kosovës , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Piruner" me nr. të prokurimit:

"214-23-8209-1-2-1". Ndërkaq me datën 15.09.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE "AgriBau"SH.P.K. me datën 19.09.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK.

AK – Policia e Kosovës merr vendim qe te refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE"AgriBau" SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Piruner" me numër te prokurimit "214-23-8209-1-2-1" iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Policia e Kosovës si dhe te mbetet ne fuqi vendimi mbi anulim aktivitetit te prokurimit nga AK-Policia e Kosovës.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues"AgriBau" SH.P.K. me datën 30.09.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 748/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 35,000.00 € .

- *Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AgriBau" SH.P.K. janë parashtruar si në vijim**:**

OE ankues pretendon se vendimi i AK-së për eliminimin e kompanisë tonë është në kundërshtim me Nenin 1, 59 dhe 72 të LPP-së. Ne jemi eliminuar me arsyetimin se " nuk keni dorëzuar katalogun, keni ofruar vetëm foto dhe keni shënuar vet te dhëna ku nuk dëshmon modelin e ofruar dhe nuk e plotëson kriterin kualifikues të DT-së. AK ka kërkuar katalog me të dhëna të mjaftueshme për vlerësim sipas aneksit 1 të DT-së, që do të thotë se katalogu duhet ti ketë të dhënat të cilat ju i keni kërkuar te aneksi 1 dhe për këtë arsye ne kemi dërguar katalogun i cili përmban të gjitha të dhënat e kërkuara për vlerësim si dhe modelin e pajisjes, viti i prodhimit, gradacionin për pajisjen, foto të pajisjes dhe nuk qëndron fakti se ne nuk kemi dhënë-dëshmuar modelin e pajisjes me të cilin ofertojmë. Ne nuk e kuptojmë se çka keni nënkuptuar me fjalën katalog, si dhe çfarë duhet të posedoj tjetër një katalog i pajisjes apo si e keni klasifikuar fjalën katalog.

- *Shqyrtimi dhe administrimi i provave-*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05/10/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 748/23, ndërsa me datë 20/10/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtuese me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues për Lot 1, Lot 2 të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe

rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”

Lidhur me pretendimet e OE“AgriBau” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0748 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti Shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: “*Katalog për të gjithë artikujt me të cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike të ofruara sipas Aneksit 1 të dosjes së tenderit*”.

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “*Katalogu për të gjithë artikujt me detaje të mjaftueshme për vlerësim sipas Aneksit 1 të dosjes së tenderit*”.

Pas analizimit të dokumentacioneve të ofruara në E prokurim, eksperti shqyrtues, sqaron se për plotësimin e kërkesës së DT-së së lartcekur, OE ankues ka ofruar dëshminë me emërtim Katalogu me specifike teknike Lot 1; Lot 2;, dokumenti përmban fotografin e produktit dhe përshkrimin e produktit.

AK në përgjigjen për rishqyrtim ka theksuar se: citat: “*Në ofertën tuaj ju nuk keni dorëzuar asnjë katalog, OE ka dorëzuar një dokument të prezantuar si katalog të përgatitur me foto të bashkangjitura dhe vetëm keni përshkruar specifikat teknike të kërkuara në dosjen e tenderit dhe nuk keni ofruar katalogun e prodhuesit....*” mbyll citatin.

Eksperti Shqyrtues vlerëson se AK nuk ka respektuar në tersi paragrafët e nenit 59 të LPP-së, për faktin se kërkesë e dosjes së tenderit nuk është kërkuar që katalogu të jetë nga prodhuesi, dhe dokumenti i ofruar nga OE ankues i cili i përmban të dhënat e kërkuara në aneksin 1 të DT-së, plotëson kërkesën e DT për faktin se AK kërkesën e ka përgjithësuar, dhe nuk e ka specifikuar që kërkesa të jetë nga prodhuesi, dhe implementimi i një kërkesë duke specifikuar prodhuesin në rastin konkret bie ndesh me nenin 56.3 të LPP-së i cili thotë: citat “*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit* “mbyll citatin.

Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues-

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në ketë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues vlerëson se raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i

tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues me qellim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, ka administruar si prova: Raportin e Ekspertit Shqyrtues, ankesa e OE"AgriBau" SH.P.K.,Njoftimin për Kontratë, i datës 09.08.2023, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i datës 15.09.2023, për anulimin e aktivitetit prokurimit me titull: "Furnizim me Piruner" me nr. të prokurimit: "214-23-8209-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– Policia e Kosovës.

Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE"AgriBau" SH.P.K, raporti i ekspertit është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit të gjitha pretendimet ankimore të OE"AgriBau" SH.P.K janë konstatuar si të bazuara.

Paneli Shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar në tërsi paragrafët e nenit 59 të LPP-së dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Piruner" me nr. të prokurimit: "214-23-8209-1-2-1", për faktin se kërkesë e dosjes së tenderit nuk është kërkuar që katalogu të jetë nga prodhuesi, dhe dokumenti i ofruar nga OE ankues i cili i përmban të dhënat e kërkuara në aneksin 1 të DT-së, plotëson kërkesën e DT, Andaj dhe pretendimet ankimore te OE ankues lidhur me shkeljet e ligjit nga Autoriteti Kontraktues në ketë aktivitet prokurimi janë të qëndrueshme e të bazuara në ligj. Paneli shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues Policia e Kosovës që në procesin e Ri-vlerësimit te këtij aktivitetin të prokurimit t'i eliminojnë të gjitha shkeljet e konstatuara të ligjit të bëra në dëm të OE"AgriBau" SH.P.K, dhe për këtë ta njoftojnë Organin e Shqyrtimit Publik.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik "AgriBau" SH.P.K duhet të miratohet si e bazuar. Paneli shqyrtues përfundimisht ka vendosur të anulohet, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i datës 15.09.2023, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Piruner" me nr. të prokurimit: "214-23-8209-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës, dhe lënda kthehet në RI-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **AGRI BAU SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: